



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



**EKONOMIA DHE BUXHETI**

KORRIK, 2008

# Raporti Mujo

Korrik 2008

Kontakt:

Telefon: ++355 (4) 225 8437

e-mail: [elami@minfin.gov.al](mailto:elami@minfin.gov.al)

[www.minfin.gov.al](http://www.minfin.gov.al)

## PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE .....	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE.....	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi mesatar i këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	7
7. Oferta e Parasë	8
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL.....	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Sufiçitetit	12
ANEKSI STATISTIKOR .....	13


## VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Korrik, 2008 arriti në 99.6 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Korrik ishte 4.0 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhes vendase* me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Korrik 2008 ishte 77.24 lekë për dollarë dhe 121.87 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Korrik shënuan kuotat 7.37 përqind për depozitat 24 mujore, 7.72 për ato 12 mujore, 5.99 për 6 mujorët dhe 5.21 përqind për depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 11.45 përqind për huatë 12 mujore dhe 12.49 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 787 miliardë lekë në muajin Korrik, duke shënuar një rritje prej rreth 14.0 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave për 6 – muajin e parë të vitit 2008* rezultoi me një defiqit të përgjithshëm prej 17.0 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Korrik, 2008 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 5.9 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara në Janar - Korrik, 2008 arritën në rreth 161.1 miliardë lekë ose rreth 53.1 përqind e planit vjetor 2008
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 166.7 miliardë lekë ose rreth 46.3 përqind e totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2008

## ZHVILLIMET EKONOMIKE

### 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Korrik 2007 pësoi një rënie prej 0.6 përqind krahasuar me muajin Qershor dhe Maj, kur ky indeks shënonte përkatësisht -0.8 përqind dhe -1.0 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë



**Ndryshimet mujore të IÇK-së**

Burimi: INSTAT

ishin -0.3 përqind, -0.6 përqind dhe -0.8 përqind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit Korrik u konstatua në grupin “Ushqime dhe pije joalkolike” 1.6 përqind, rënie e cila erdhi si rrjedhojë e rënies së çmimeve të nëngrupit “Ushqime” me 1.7 përqind, si dhe rënies së çmimeve të nëngrupit “Zarzavate përfshirë patate” me 10.2 përqind. Pësha specifike relativisht e lartë që zë ky grup në

shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ndieshme mbi normën e inflacionit. Gjatë këtij muaji rritjen më të madhe prej 1.8 % e pësoi indeksi i çmimit të grupit “Transporti”.

**Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)**


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2007	2.9	2.9	2.7	1.9	1.4	2.0
2008	3.0	3.6	4.6	4.4	4.2	4.0
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2007	2.1	4.2	4.4	4.2	3.5	3.1
2008	3.7					

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Korrik arriti në 3.7 përqind duke qëndruar në brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2007 dhe 2008 paraqiten në tabelën 1.

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Korrik 2008, arriti në 121.87 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie prej 0.14 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Korrik një euro u këmbye me 121.80 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Korrik 2008, arriti në 77.24 lekë/dollarë duke shënuar një rënie prej 1.55 përqind kundrejt muajit Qershor. Në fund të muajit Korrik, dollari amerikan arriti nivelin 78.01 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Korrik të vitit të



**Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë Korrik**


ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 1.578 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë muajit Maj përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitetin e politikës fiskale, efikasitetin në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, rritjen e flukseve hyrëse në valutë etj.


kaluar rezultojnë se monedha shqiptare është vlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 13.4 përqind dhe kundrejt monedhës europiane, Euro, me 0.3 përqind. Mbicimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Korrik 2008, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 7.72 përqind, duke pësuar një rritje prej 1.07 përqind në krahasim me muajin Qershor, ku normat e interesit shënonin vlerën 6.65 përqind. Rritje për këtë muaj kanë



**Normat e interesit për depozitat**




**Normat e interesit për huatë**

maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin përkatësisht 8.21 përqind, 7.46 përqind dhe 6.28 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rritje në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 dhe 3 mujor.

pësuan depozitat me afat 6-mujor të krahasuara me muajin paraardhës me 0.23 përqind, normat e interesit për depozitat me afat 3 - mujor me 0.21 përqind, si dhe normat e depozitave me afat 1 - mujor me 0.02 përqind krahasuar gjithmonë me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rritje kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat 12, 6, 3 dhe 1 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Korrik pësoi një rritje 0.05 pikë përqind, duke arritur në 11.45 përqind nga 11.40 përqind që ishte në muajin Qershor. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rënie prej 1.17 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Korrik arriti në 12.49 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Korrik 2008, për bonot me


## 4. Bilanci i Pagesave



### **Bilanci i Pagesave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Qershor 2008 regjistroi një deficit të përgjithshëm prej 17.0 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.




### **Llogaria Korente**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korente prej 590.7 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën janar'08 - qershor'08 rezultoi: (i) bilanci tregtar - 1,106.9 mln euro, (ii) shërbime neto -82.6 mln euro, (iii) të ardhura neto 129.3 mln euro, (iv) transfera neto 469.5 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në grafikun 6.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Korrik 2008, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 31,613.3 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2007. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rënies të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 1,263.3 milionë lekë dhe të rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 30,350 milionë lekë.



Në muajin Korrik sistemi bankar rezulton me një rritje prej 2,317.2 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Qershor, rritje e cila erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 2,207.5 milionë lekë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 4,524.7 milionë lekë.

## 6. Kredia për Ekonominë


Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Korrik 2008 arriti në 356.8 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2007 shënoi vlerën 62.9 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 21.4 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjatë këtij muaji shënoi rritje duke ndjekur kështu të njëjtin trend rritës si në vitin 2007.

Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 72.3 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 258 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 36.2 përqind.


## 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Korrik ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës Qershor. Kjo ofertë arriti në rreth 787 miliardë lekë në fund të muajit Korrik duke shënuar një rritje prej 29.4 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në




muajin Dhjetor 2007. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 14.0 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar. Kjo rritje vjetore, erdhi si pasojë e rritjes së depozitave pa afat në lekë me rreth 4.2 përqind, rritjes së depozitave në valutë me rreth 27.1 përqind, depozitave me afat në lekë me rreth 12.9 përqind dhe rënies të parasë jashtë sistemit me rreth 0.7 përqind.

Ndikimin kryesor në rritjen e ofertës monetare gjatë muajit Korrik e kanë patur rritja e depozitave pa afat në lekë, të cilat vetëm gjatë këtij muaji u rritën me rreth 1.8 miliardë lekë, rritjes së depozitave në valutë me 4.1 miliardë lekë, si dhe rritjes së depozitave me afat në lekë me rreth 2.1 miliardë lekë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, në fund të muajit Korrik arriti në 19.2 përqind duke shënuar një rritje në krahasim me muajin Qershor. Raporti i parasë jashtë bankave me depozitat në muajin Korrik arriti në rreth 23.7 përqind, duke shënuar një rritje prej 0.4 përqind e krahasuar me muajin Qershor.



Graf - 10




Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 3.9 miliardë lekë në krahasim me muajin Qershor.

**Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Graf - 11



Depozitat në valutë gjatë muajit Korrik, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 75.8 përqind të depozitave totale në valutë.

**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë


## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Korrik 2008 sektori i individëve, zuri nivelin më të lartë të depozitave pa afat në lekë, me rreth 53.9 përqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 34.5 përqind dhe nga ndërmarrjet publike jofinanciare, me 8.8 përqind. Individët dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me

rreth 75.8 përqind dhe rreth 19.8 përqind. Familjarët ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (94.8 përqind e totalit)

Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 517 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 635 miliardë lekë në muajin Korrik 2008. Ata ndiqen nga sektori privat (92 miliardë), ndërmarrjet publike jo-financiare (18.2 miliardë) dhe autoritetet

Graf - 12



### **Përberja e depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

lokale (3.4 miliardë). Institucionet financiare kontribuan me rreth 4.1 miliardë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Korrik 2008, krahasuar me një muaj më parë Qershor, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 8.1 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së depozitave në valutë dhe atyre në lekë.


## SEKTORI FISKAL

### 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhen Janar - Korrik, janë mbledhur rreth 161.1 miliardë lekë të ardhura, përkundrajt shpenzimeve të përgjithshme prej 166.7 miliardë lekë, që përfshijne 129.8 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 34.7 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 39.3 % financim i brendshëm, dhe 60.7 % financim i huaj.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 53.1 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2008, ndërsa shpenzimet përbëjnë 46.3 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë

rreth 50.3 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 36.8 % e këtij planifikimi. Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 113.4 miliardë lekë (ose rreth 54.1 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 7.1 miliardë lekë (45.6 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 26.8 miliardë lekë (52.4 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 13.2



Treguesit Fiskal, Korrik 2008

miliardë lekë (58.2 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 129.8 miliardë lekë, 35.6 miliardë lekë (27.5 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 18.8 miliardë lekë (14.5 %) për interesat, 12.8 miliardë lekë (9.9 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 0.9 miliardë lekë (0.7 %) për subvencione, 41.8 miliardë lekë (32.2%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 12.7 miliardë lekë (9.8 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 7.1 miliardë lekë (5.4 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 52.5 % (shpenzime personeli), 57.6 % (shpenzime për interesat), 44.7 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 48.9 % (subvencione), 53.1 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 40.2 % dhe 45.7 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrajt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 27.9 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 46.3 %.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Korrik 2008 ishin rreth 161.1 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 147.274 miliardë, grantet 623 milionë dhe të ardhurat jo-tatimore në rreth 13.2 miliardë

**Tab - 2** Të ardhurat e realizuara në Janar - Korrik 2008

Burimi	Miliardë Lekë
TVSH	59.1
Tatimi mbi fitimin	10.9
Taksa doganore	4.9
Taksat nacionale	8.4
Akcizat	17.7
Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë	1.5

## 3. Financimi i Bilancit Fiscal

Deficiti prej 5.9 miliardë lekë, për periudhën Janar-Korrik, u mbeshtet në vlerën 5.9 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 11.5 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjete kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Korrik disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 26.2 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 29.4 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhë kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 17.3 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 22 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me 6.7 miliardë lekë.

## Aneksi Statistikor

Tab - 1

**Ndryshimi i Indeksit të Çmimemeve të Konsumit**  
Change of Consumer Prices Index

Muaji	Mujor (Monthly)				Mesatar Mujor (Monthly Average)				Vjetor (Annual)				Month
	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008	
Janar	0.8	0.2	0.5	0.5	0.80	0.20	0.50	0.50	3.3	1.4	2.9	3.0	January
Shkurt	0.4	0.4	0.5	1.0	0.60	0.30	0.50	0.75	1.8	1.3	2.9	3.6	February
Mars	0.0	0.1	-0.1	0.9	0.40	0.23	0.30	0.80	1.6	1.5	2.7	4.6	March
Prill	-0.3	0.6	-0.2	-0.4	0.23	0.33	0.18	0.50	1.3	2.4	1.9	4.4	April
Maj	-1.1	-0.4	-0.8	-1.0	-0.04	0.18	-0.02	0.20	2.0	3.1	1.4	4.2	May
Qershor	-0.5	-1.1	-0.6	-0.8	-0.12	-0.03	-0.12	0.03	2.9	2.4	2.0	4.0	June
Korik	-1.2	-0.4	-0.3	-0.6	-0.27	-0.09	-0.14	-0.06	1.8	3.2	2.1	3.7	July
Gusht	0.2	-0.2	1.9		-0.21	-0.10	0.11		2.3	2.8	4.2		August
Shtator	0.9	0.6	0.9		-0.09	-0.02	0.20		3.1	2.6	4.4		September
Tetor	0.4	0.1	-0.1		-0.04	-0.01	0.17		3.3	2.2	4.2		October
Nendor	0.2	0.9	0.2		-0.02	0.07	0.17		3.0	2.9	3.5		November
Dhjetor	2.2	1.8	1.3		0.10	0.22	0.27		2.0	2.5	3.1		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

<b>Tab - 2</b> <b>Kursi i kembimit</b>		Leke per njesi te monedhes se huaj (Leke per unit of foreign currency)														
Exchange rate																
Monedha	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008							Currency
									Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	
<i>Mesatarja e periudhes</i>																
USD	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	98.10	90.43	83.39	83.90	80.32	77.79	78.45	78.46	77.24	Average of period USD
EURO	132.58	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.08	123.63	122.61	123.69	124.59	122.68	122.08	122.03	121.87	EURO
<i>Fundi i periudhes</i>																
USD	146.08	137.04	135.97	106.58	92.64	103.58	93.67	82.89	82.61	82.58	78.29	78.94	78.65	77.17	78.01	In the end of period USD
EURO	-	-	137.90	134.32	126.35	122.58	123.70	121.78	122.61	125.34	123.70	122.75	122.01	122.05	121.80	EURO

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me baze vjetore

Annual Interest Rates

		2008							
Ne perqindje Fundi I periudhes	Dhjetor 07 Dec	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	In percent End of period
<b>Norma e remunerimit</b>									<b>Remuneration rate</b>
ne leke	-	4.37	4.37	4.37	4.37	4.37	....	4.37	In Lek
ne usd	-	2.30	2.19	1.87	2.02	1.87	....	1.72	In USD
ne euro	-	2.92	2.93	3.07	3.07	3.07	....	3.14	in EURO
<b>Norma e depozitave</b>									<b>Deposits rates</b>
12-M	6.33	6.49	6.10	6.11	6.41	6.72	6.65	7.72	12-M
6-M	5.50	5.56	5.44	5.42	5.64	5.61	5.76	5.99	6-M
3-M	4.85	5.08	4.80	4.84	5.08	4.96	5.00	5.21	3-M
1-M	3.21	3.59	3.48	3.58	3.62	4.36	4.61	4.63	1-M
<b>Norma e huase</b>									<b>Lending rates</b>
12-M	13.55	13.36	11.78	11.48	12.92	11.50	11.40	11.45	12-M
6-M	13.85	15.53	14.29	13.50	12.40	12.40	13.66	12.49	6-M
<b>Norma e letrave me vlere</b>									<b>Securities rates</b>
Bobo thesari 1/									Treasury bills 1/
3-M	6.48	6.20	6.26	6.25	6.29	6.28	6.27	6.28	3-M
6-M	7.51	7.30	7.29	7.36	7.47	7.48	7.46	7.46	6-M
12-M	8.41	8.14	8.00	8.02	8.12	8.16	8.19	8.21	12-M

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREQUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2008

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2008

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks)

Nr.	E M E R T I M I	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	ITEM	No.
	<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>63,566</b>	<b>87,807</b>	<b>111,542</b>	<b>134,889</b>	<b>161,135</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>	
I.	<b>Ndihma</b>	<b>41</b>	<b>250</b>	<b>466</b>	<b>521</b>	<b>623</b>	<b>Grants</b>	<b>I.</b>
II.	<b>Te ardhura tatimore</b>	<b>60,462</b>	<b>82,618</b>	<b>103,004</b>	<b>123,998</b>	<b>147,274</b>	<b>Tax Revenue</b>	<b>II.</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>46,867</b>	<b>62,853</b>	<b>79,253</b>	<b>96,093</b>	<b>113,410</b>	<b>From tax offices and customs</b>	<b>II.1</b>
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	24,021	32,423	40,714	49,745	59,085	V. A. T	1
2	Tatimi mbi Fitimin	6,052	7,305	8,646	9,839	10,876	Profit Tax	2
3	Akcizat	6,518	9,070	12,044	14,940	17,737	Excise Tax	3
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	4,817	6,563	8,332	9,996	12,349	Personal Income Tax	4
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	3,400	4,656	5,966	7,309	8,410	National Taxes and others	5
6	Taksa Doganore	2,059	2,835	3,550	4,264	4,953	Custom Duties	6
II.2	<b>Te ardhura nga Pushteti Lokal</b>	<b>2,422</b>	<b>4,345</b>	<b>4,858</b>	<b>5,462</b>	<b>7,106</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>	<b>II.2</b>
1	Taksa Lokale	1,677	3,160	3,570	4,050	5,290	Local Taxes	1
2	Tatimi mbi Biznesin e vogel	745	1,185	1,289	1,412	1,816	Small Business Tax	2
II.3	<b>Te ardh. Buxh. Pavarur</b>	<b>11,173</b>	<b>15,420</b>	<b>18,893</b>	<b>22,443</b>	<b>26,758</b>	<b>Social ins</b>	<b>II.3</b>
1	Sigurimi Shoqeror	9,973	13,776	16,875	20,048	23,918	Social Insurance	1
2	Sigurimi Shendetesor	1,201	1,644	2,018	2,395	2,841	Health insurance	2
III.	<b>Te ardhura Jotatimore</b>	<b>3,063</b>	<b>4,939</b>	<b>8,072</b>	<b>10,371</b>	<b>13,238</b>	<b>Nontax Revenue</b>	<b>III.</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0	0	1,500	1,500	1,500	Profit transfer from BOA	1
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	2,878	4,355	5,419	6,427	6,935	Income of budgetary institutions	2
4	Te tjera	185	584	1,153	2,444	4,803	Other/not allocated	4
	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>53,214</b>	<b>78,466</b>	<b>105,621</b>	<b>137,320</b>	<b>166,722</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>	
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>48,032</b>	<b>67,306</b>	<b>87,291</b>	<b>107,787</b>	<b>129,752</b>	<b>Current Expenditures</b>	<b>I.</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>14,172</b>	<b>19,631</b>	<b>24,700</b>	<b>29,991</b>	<b>35,646</b>	<b>Personnel expenditures</b>	<b>I.1</b>
1	Paga	11,730	16,307	20,546	24,946	29,743	Wages	1
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	2,442	3,324	4,154	5,045	5,904	Social insurance contributions	2
3	Politikat e reja pagash						Of which; Contingency	3
I.2	<b>Interesat</b>	<b>6,926</b>	<b>9,190</b>	<b>12,359</b>	<b>15,021</b>	<b>18,758</b>	<b>Interest</b>	<b>I.2</b>
1	Te Brendshme	6,578	8,714	11,304	13,636	17,308	Domestic	1
2	Te Huaja	348	476	1,055	1,385	1,451	Foreign	2
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirembajtje</b>	<b>3,703</b>	<b>5,744</b>	<b>7,856</b>	<b>10,451</b>	<b>12,804</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>	<b>I.3</b>
I.4	<b>Subvencionet</b>	<b>207</b>	<b>287</b>	<b>700</b>	<b>884</b>	<b>961</b>	<b>Subsidies</b>	<b>I.4</b>
I.5	<b>Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera</b>	<b>16,640</b>	<b>22,642</b>	<b>28,623</b>	<b>35,022</b>	<b>41,796</b>	<b>Social insurance outlays</b>	<b>I.5</b>
1	Sigurime Shoqerore	14,400	19,554	24,641	30,154	36,002	Social insurance	1
2	Sigurime Shendetesore	2,240	3,088	3,983	4,868	5,794	Health insurance	2
I.7	<b>Shpenzime per Buxhetin Lokal</b>	<b>3,776</b>	<b>6,105</b>	<b>8,222</b>	<b>10,469</b>	<b>12,723</b>	<b>Local Budget</b>	<b>I.7</b>
I.8	<b>Shpenzime te tjera</b>	<b>2,608</b>	<b>3,707</b>	<b>4,831</b>	<b>5,950</b>	<b>7,062</b>	<b>Other expenditures</b>	<b>I.8</b>
1	Pagesa e Papunesise	193	260	344	425	499	Unemployment insurance benefits	1
2	Ndihma Ekonomike	2415	3,448	4,486	5,524	6,563	Social assistance	2
3	Kompensim per ish te permdjekurit politike						Compensation for ex political prisoners	3
I.9	<b>Kompensim ne vleren e pronareve</b>						<b>Property Compensation</b>	<b>I.9</b>
II.	<b>Fondi Rezerve</b>						<b>Reserve fund/contingency</b>	<b>II.</b>
III.	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>5,182</b>	<b>10,262</b>	<b>16,984</b>	<b>28,016</b>	<b>34,744</b>	<b>Capital expenditures</b>	<b>III.</b>
1	Financimi Brendshem	4,345	5,882	8,262	11,307	13,648	Domestically financed	1
2	Financimi Huaj	837	4,380	8,722	16,709	21,096	Foreign financed	2
IV	<b>Rindertimi i Gerdecit</b>		<b>898</b>	<b>1,346</b>	<b>1,517</b>	<b>2,227</b>		
	<b>DEFICITI</b>	<b>10,352</b>	<b>9,341</b>	<b>5,921</b>	<b>-2,431</b>	<b>-5,588</b>	<b>Overall Deficit</b>	
	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-10,352</b>	<b>-9,341</b>	<b>-5,921</b>	<b>2,431</b>	<b>5,588</b>	<b>Deficit Financing</b>	
	<b>Brendshem</b>	<b>-10,561</b>	<b>-9,877</b>	<b>-7,225</b>	<b>-8,464</b>	<b>-5,931</b>	<b>Domestic</b>	
	Te ardhura nga privatizimi	121	198	298	400	686	Privatization receipts	
	Hua-marrije e brendeshme	5,450	5,100	6,563	10,517	5,856	Domestic Borrowing	
	Te tjera	-16,132	-15,175	-14,085	-19,381	-12,473	Other	
	<b>I Huaj</b>	<b>209</b>	<b>536</b>	<b>1,303</b>	<b>10,896</b>	<b>11,519</b>	<b>Foreign</b>	
	Hua afatgjate(e marre)	910	1,070	1,834	12,357	13,157	Long-term Loan(Drawings)	
	Ndryshimi i gjendjes se arkës*	-178	35	38	145	139	Chang. of stat. Account*	
	Ripagesat	-523	-569	-569	-1,606	-1,778	Repayments	
	<b>KAPITUJT KRYESORE</b>						<b>Main indicators</b>	
	Financimi i Brendshem i Deficitit						Domestically financed deficit	
	Deficiti Pergjithshem						Overall Balance	
	Te ardh. Shpen. nga Sig. Shoq. dhe Shend.						Soc. & health insur. contr.-outlays	

\* "Ndryshimi i gjendjes se arkës" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja

"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

Tab - 5

## SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT INSTITUCIONAL PER VITIN 2008

Expenditures by central institutions during the year 2008

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks)

Ministria ose Institucioni	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Ministry or Institution
<b>Totali</b>	<b>53,098</b>	<b>78,466</b>	<b>105,621</b>	<b>137,320</b>	<b>166,722</b>	<b>Total</b>
Presidenca	33	44	59	69	83	President
Kuvendi	198	266	333	406	500	Parliament
Keshilli i Ministrave	66	100	127	130	157	Council of Ministers
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	172	375	512	586	651	Ministry of Economy, Trade & Energy
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe mbrojtjes se Konsumatorit	574	891	1,226	1,673	2,256	Ministry of Agriculture, Food & Consumers Safety
Ministria e Puneve Publik, Transportit dhe Telekomunikacionit	4,219	8,566	14,771	24,299	29,913	Ministry of Public Work, Transport & Telecommunication
Ministria e Financave	1,034	1,509	1,911	2,401	2,819	Ministry of Finance
Ministria e Arsimit dhe Shkences	6,237	8,825	11,634	14,551	17,455	Ministry of Education & Science
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	274	435	587	775	898	Ministry of Turisem, Culture, Youth & Sport
Ministria e Shendetesise *	4,713	6,778	8,722	10,834	12,839	Ministry of Health
Ministria e Drejtjesise	670	971	1,278	1,661	2,009	Ministry of Justice
Ministria e Puneve te Jashtme	528	713	895	1,132	1,332	Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Brendshme	2,600	3,572	4,633	5,975	7,085	Ministry of Interior
Ministria e Mbrojtjes	3,167	4,364	5,363	6,974	8,286	Ministry of Defense
Sherbimi Informativ I Shtetit	232	315	393	475	564	State Information Service
Drejtoria e Radio-Televizionit	101	132	191	228	262	Department of Radio and Television
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	26	44	52	64	88	General Directorate of Archive
Akademia e Shkencave	12	20	25	33	40	Science Academy
Sherbimi i Kontrollit te Shtetit	53	71	90	111	131	State Audit Commission
Ministria e Punes, Ceshjteve Sociale dhe Shanseve te barabarta**	16,346	22,385	28,420	34,830	41,721	Ministry of Labor and Social Affairs & Equal Possibilities
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	209	344	435	569	676	Ministry of Environment, Foristry & Water Administration
Prokuroria e Pergjithshme	200	278	354	444	525	State Prosecutor
Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	250	348	450	543	678	Office for the Administration of the Judiciary Budget
Gjykata Kushtetuese	18	26	34	44	60	Constitutional Court
Agjensia Telegrafike Shqiptare	36	37	47	54	63	Albanian Press Agency
Shpenzime per sherbimin e borxhit	6,926	9,190	12,359	15,021	18,758	Dept Service
Instituti i Statistikes	39	51	69	81	94	Statistics Institute
Autoriteti i Mbkqyrjes Financiare	8	10	13	13	13	Securities Commission
Shkolla e Magjistratures	11	15	18	24	32	School of the Magistature
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	119	215	265	378	522	Rural Development Program
Qendra Kombetare Kinematografike	8	40	70	90	96	National Movies Center
Instituti i integrimit te perndjekurve	7	11	13	16	19	Institute of integration of the ex political prisoners
Inspektoriat i keshillit te larte te drejtjesise	16	22	27	39	45	Inspection of the high Council of Justice
Avokati i popullit	20	31	37	45	59	Ombudsman
Komisioni i Sherbimit Civil	8	11	14	17	22	Commission of civil service
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	23	31	37	44	53	Central Committee for Elections
Entet Lokale "Granti"	3,776	6,105	8,222	10,469	12,723	Local Entities "Grant"
Inspektoriat i Larte Kontr. Deklar te Pronave	12	21	32	39	46	High Inspectoriate for Declaration of Properties & Assets
Autoriteti i Konkurences	10	18	21	25	29	Competition Authority
Ministria e Integrimit	24	33	44	53	67	Ministry of Integration
Agjentet tatimor jo-buxhetore	19	71	110	155	201	Tax agents not-budgetary
Keshilli Kombetar I Kontabilitetit	2	2	3.39	3.87	5	
Avokati I Prokurimeve	5	9	10.98	16.49	18	
Te tjera	96	1,171	1,716	1,928	2,831	

Te dhena operative

**Tab - 6 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL PER VITIN 2008**  
EXPENDITURES BY FUNCTIONS YEAR 2008

*Te dhena progresive (Progressive Data)* *ne milion leke (in million leks)*

Kodi	Funksonet	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Functions	Code
		Mar	Apr	May	Jun	Jul		
	<b>TOTAL</b>	<b>53,098</b>	<b>78,466</b>	<b>105,621</b>	<b>137,320</b>	<b>166,722</b>	<b>TOTAL</b>	
01	Sherbimet e Pergjithshme Publike *	12,438	17,329	22,917	28,161	34,647	General Public Services	01
02	Mbrojtja	1,840	2,511	3,026	4,181	4,968	Defense	02
03	Rendi dhe Siguria Publike	2,760	3,860	5,071	6,551	7,859	Public Order and Safety	03
04	Ceshtjet Ekonomike	5,253	10,562	16,932	27,270	33,815	Economic affairs	04
05	Mbrojtja e Mjedisit	18	29	35	46	53	Environmental protection	05
06	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	1,231	2,065	3,340	4,242	5,173	Housing and community amenities	06
07	Shendetesia	4,760	6,816	8,773	10,914	12,933	Health	07
